

Data 07.03.2023

**PROCESVERBAL – Procedurë e Hapur e Thjeshtuar - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“BLERJE GOMA PER AUTOMJETET ”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): **34330000-9**

VLERA E FONDIT LIMIT: **1.782.400** (Njemilion e shtateqind e tetedhjetë e dymijë e katerqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**“ BLERJE GOMA PER AUTOMOJETET ”**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP si dhe në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Këto kërkesa vendosen për të provuar se operatori ekonomik vepron konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP.

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Ak-kerkon nga operatorët ekonomike qe te paraqesin:

- a. Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2019, 2020 dhe 2021, ku vlera mesatare e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar

te jete jo me e vogel se 40 % të vlerës së fondit limit të kontratës, qe prokurohet, konkretisht ne vleren **712.960** leke pa Tvsh.

- b. Kopje e vertetuar te bilanceve te tre viteve te fundit (2019, 2020 dhe 2021) te paraqitur prane Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet *ku te paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet*”.

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, shërbime.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, në pikën 2/c, neni 43 dhe pikën 4, neni 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar se operatori ekonomik i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara 2019,2020,2021 për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për tu njohur me gjendjen ekonomike të operatorit ekonomik të paktën për dy vitet e fundit, për të pasë siguri që operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

**Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:**

Pika 1 dhe pika 2/c, neni 43 si dhe pika 2, neni 55 e VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar . Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.*

**Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

- c. Vertetim te leshuar nga autoritetet vendore, për shlyerjen e taksave vendore te parashikuara per vitin **2022**.

**Per plotesimin e kriterit te mesiperm eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).**

*Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe "Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j", te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin .*

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin Nr.9632 date 30.10.2006 "Per sistemin e taksave vendore i ndryshuar"

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë **jo më të vogël** se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe Vertetim per realizimin me sukses te kontrates/ fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, *te plotesuara sipas legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore* ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. "

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 "Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" si dhe pikes 4/b, nenit 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" (i ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet. Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë kanë përvojë të mëparshme për procedura të ngjashme me objektin që prokurohet si dhe kanë përmbushur me sukses kontratën për të cilën janë shpallur fitues. Kjo tregon se operatori ekonomik është vazhdimisht i angazhuar në treg me kontrata furnizimi, çka rrit besueshmërinë te Autoriteti Kontraktor se në rast shpallje fitues, ekzekutimi i kontratës do të jetë në përputhje me përcaktimet e DST, dispozitat e kontratës dhe planit të zbatimit të kontratës. Për shkak të rëndësisë që ka vet Autoriteti Kontraktor, llojit të mallit objekt prokurimi, i rëndësishëm për funksionimin e automjeteve të Prokurorisë së Posaçme, me qëllim që të hyjmë në marrëdhënie kontraktuale me operatorë ekonomikë seriozë në treg, me performancë të mirë e të vazhdueshme, aplikojmë marzhin maksimal të vlerës së parashikuar.

**2.3.1.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqes **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit dhe te ndërrimit te gomave te Automjetit(sipas nevojave te autoritetit kontraktor)** në adresat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të ketë minimumi një ambient pune (gomisteri) të përshtatshme brenda territorit të Bashkisë së Tiranës. Për këtë, operatori ekonomik ofertues, duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton pronësinë/ huapërdorjen/ qiramarrjen si më poshtë:

**a.** Dokumentacion që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj; ose
- kontrata e shitblerjes; ose
- kontrata e dhurimit; ose
- çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

**b.** Dokumentacion që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje (e vlefshme).

**c.** Dokumentacion që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje (e vlefshme).

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, shërbime.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është vendosur në bazë të nenit 77, Kreu XII të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, pikës 8, nenit 40, Kreu V të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Në mënyrë që të vërtetohet që operatorët ekonomikë disponojnë hapësirën e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjykojmë se është e nevojshme demonstrimi i këtij fakti përmes paraqitjes së një dokumenti i cili vërteton pronësinë, huapërdorjen, qiramarrjen referuar dispozitave përkatëse të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë **deklaratë mbi garancinë e gomave**, garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, shërbime.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin e gomave.

**3.** Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet qe ka ne dispozicion apo mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik. Kerkohet te jene ne dispozicion keto mjete pune.

| <i>I. Mjetet</i>            | <i>Sasia</i>  | <i>Gjendja</i>             |
|-----------------------------|---------------|----------------------------|
| <i>( Kamion ose furgon)</i> | <i>cope 1</i> | <i>Pronësi ose me qera</i> |

*Per te deshmuar kete, operatorët ekonomike duhet te paraqesin dokumentat e meposhtme:*

- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike, nese jane ne pronesi, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor te vlefshme, çertifikate e pronesise se mjetit).
- Per mjetet qe shenohen ne regjistrat publik, nese jane me qera, duhet te paraqiten dokumenta qe vertetojne regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, polica e sigurimit vjetor, si dhe kontrata perkatese te qerases te vlefshme).

***(Per plotesimin e kriterit te mesiperme eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates sipas shtojces Nr.8 (Formulari permbledhes i vetedeklarimit).***

*Ne lidhje me momentin e paraqitjes se dokumentacionit deshmuës per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes te vetedeklarimit, mbajme ne konsiderate percaktimet e nenit 26, pika 6, te VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar , ku parashikohet qe “Perpara publikimit te njoftimit t e fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese te parashikuara ne shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, te pikes 2 te ketij neni , si dhe dokumentet e tjera shoqeruese te ofertes, te dorezuara ne rruge elektronike. Keto dokumente duhet te paraqiten ne original ose ne kopje te njehsuara me origjinalin ).*

**Rekomandimi Nr. 7998 Prot., dt. 24.12.2021 ”Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim per procedurat e prokurimit per mallra, pune, sherbime.**

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 5/ç e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

1. Gomat duhet të jenë të reja. Gomat nuk duhet te jenë të riveshura.
2. Të gjitha gomat duhet të jenë të prodhimit për përdorim 4 (katër) stinët.
3. Indeksi i fërkimit A-B.
4. Indeksi i konsumit A-B.
5. Indeksi i zhurmës max 70Db.
6. Prodhim i 6 mujorit të dytë 2021.
7. Gomat të jenë të renditura në njërin nga dhjetë vendet e pare në “Tire brand report card 2021”
8. Të përfshihet montim+balancim i gomave.
9. Në sipërfaqen anësorë të jashtme do të jenë të stampuara shkrimi i të dhënave:
  - Prodhuesi (Marka).
  - Emërtimi i gomës.
  - Përmasat (dimensionet ) e gomës sipas porosisë të kërkuar dhe profili i batistratës.
  - Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë.

- Struktura e gomës radiale.
  - Tipi i gomës (tubeless/ Tube Type).
  - Numri i miratuar UN/ECE i prodhuesit të gomës. Kodi i prodhuesit të gomës që tregon se prodhimi i gomave bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE (e vendosur nga ata).
  - E (standarti i BE) ose DOT (standarti amerikan) Kodi i gomës.
  - Data e prodhimit.
10. Gomat e një dimesioni do të jenë sasia e kërkuar e të njëjtit tip prodhimi/ të të njëjtës markë.
11. Garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë jo më pak se 30,000 (tridhjetë mijë) km. Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit osë cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar). Specifikimet teknike hartohen nga specialisti i fushës për objektin që prokurohet. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave është:**

Data: 17/03/2023; Ora: 13:00; Vendi: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)